REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 337/19
Datë/Datum. 24.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komunës se Deçanit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **631-1-28559-2-2-1**

Sa i përket tenderit për *(***Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese***)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"AL Engineering" sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Mujë Krasniqi C7H11Nr15, Prishtinë
(Adresa)
Prishtinë *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
044/200 285
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Sami Lokaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
alengineering.ks@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.06.2019
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Me daten 07.05.2019 është bere Njoftimi për Kontratë (ri-tender)*
- *Me daten 20.05.2019, ora 15:00 – afati i fundit për dorzimin e ofertave*
- *Me daten 23.05.2019 e kemi marre njoftimin se jemi fitues te kontratës*
- *Me datën 28.05.2019 e kemi marre njoftimin për pezullim*
- *Me daten 31.05.2019 e kemi marre njoftimin për ri-shqyrtim*
- *Me datën 05.06.2019 e kemi marrur njoftimin nga AK se fitues është nsh "3D Project". Po me ketë datë nga AK kemi kërkuar qasje ne dokumenta (duke u bazuar ne ligjin nr. 03/L-2015).*
- *Me datën 06.06.2019 na ka informuar zyra prokurimit – z.Xhevdet Ramosaj se mundemi me 06.06.2019 te kemi qasje ne dokumenta.*
- *Me daten 10.06.2019 kemi berë Kerkesë për Rishqyrtim*
- *Me daten 10.06.2019 e kemi marre njoftimin për ri-pezullim*
- *Me daten 13.06.2019 kemi marre përgjigje në - Kerkesë për Rishqyrtim*
- *Kriteri për dhenjën e kontratës:* Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** ☒

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

SH.P.K. L.L.C AL ENGINEERING PRISHTINE

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Me daten 10.06.2019 kemi berë Kerkesë për Rishqyrtim
Me daten 13.06.2019 kemi marre përgjigje në - Kërkesë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

Të nderuar, fillimisht ju njoftojmë se ne jemi rekomanduar për kontratë gjatë vlerësimit të parë të ofertave, mirëpo pas kërkesës për rishqyrtim që kishte bërë një opeartor ekonomik, "Autoriteti kontraktues e kishte anuluar vendimin e tyre ndërsa pas rishqyrtimit e ka rekomanduar për kontratë OE **NSH "3D Project"** .

Pas marrjes se ri-njoftimit, se fitues është Nsh "3D Project", ne me të njëjtën datë (05.06.2019) nga AK kemi kërkuar qasje në dokumente, sipas nenit 10 të LPP-së, ndërsa me datën 06.06.2019 kemi pasur qasje në ofertat e të gjithë operatorëve ekonomik.

Në lidhje me ofertën e NSh "3D Project" – si OE i rekomanduar për kontratë nga AK – kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 1 - Dëshmia 1-8, Lista e stafit profesional e vërtetuar nga ATK, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë - nuk e ka ofruar listën e stafit e vërtetuar nga ATK-ja, prandaj konform nenit 59.4 të LPP-së ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm, sepse aty shkruan qartë "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Tek kërkesa Nr.6 – është kërkuar Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoje pune profesionale minimum 10 vite , ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sepse diploma e inxhinierit të gjeodezisë nuk është në njërën nga gjuhet zyrtare në Republikën e Kosovës dhe nuk është e përkthyer në njërën nga këto gjuhë. Ky fakt bie në kundërshtim me nenin 13.4 te LPP-së sepse aty shkruan qartë:

"*Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe,Serbe ose në gjuhën Angleze.*

Tek kërkesa Nr.8 – është kërkuar Një Master i Biologjis me licencë valide per VNM nga MMPH , ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar biologun, i cili nuk e ka diplomën e nostrifikuar dhe është nga një shtet tjetër dhe licenca për VNM nga MMPH i ka skaduar me 26.05.2019, kurse diploma nuk është në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, e ky fakt bie në kundërshtim me nenin 13.4 të LPP-së.

Në lidhje me ofertën e konsorciumit "PROing&Partners" shpk, "ARTINGS PROJECT" shpk dhe nsh "GEOCAD", ne kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së është kërkuar si në vijim:

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINE

Kërkesa 1 - Dëshmia 1-8, Lista e stafit profesional e vërtetuar nga ATK, ndërsa ky konsorcium nuk **i ka të** gjithë stafin në listën e ATK-së, sepse aty nuk figurojnë Projekt Menaxheri – Halim Bajrami dhe inxhinieri i Elektros-Afrim Rexhepi.

Tek kërkesa nr.6 – është kërkuar Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoje pune profesionale minimum 10 vite –, ndërsa konsorciumi në fjalë ka prezantuar inxhinierin por që nuk ka diplomë të nostrifikuar dhe diploma e tij nuk është në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës prandaj ky fakt bie në kundërshtim me nenin 13.4 te LPP-së.

Tek kërkesa nr 7 – është kërkuar Një Inxhinier i Diplomuar i Infrastrukturës ose master i Infrastrukturës – ndërsa konsorciumi në fjalë ka prezantuar inxhinierin, i cili nuk ka diplome te nostrifikuar, dhe nuk e ka diplomën në njërën nga gjuhët zyrtare, e ky fakt bie në kundërshtim me nenin 13.4 te LPP-së.

Tek kërkesa nr 8 – është kërkuar Një Master i Biologjis me lisenc valide per VNM nga MMPH, ndërsa konsorciumi në fjalë ka ofruar dëshminë për Biolog por nuk e ka valide licencën për VNM nga MMPH, sepse i ka skaduar me 02.06.2019

Tek kërkesa nr 9 – është kërkuar që "Operatori Ekonomik duhet të ketë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartim i projekteve (Rruge, ujësjellës, kanalizim, matje gjeodezike, parqe, kanale te ujitjes, hapësira gjelbëruese, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj.), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 75,000.00 €, ndërsa partneri "ATRINGS PROJECT" përpos certifikatës se biznesit dhe certifikatës se TVSH-së nuk posedon asnjë dokument tjetër.

Në lidhje me ofertën e konsorciumit "Infra Plus" shpk dhe "Plan 2" shpk, ne kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së është këruar si në vijim:

Kërkesa 1 - Dëshmia 1-8, është kërkuar Lista e stafit profesioanl e vërtetuar nga ATK, ndërsa konsorciumi në fjalë ka ofruar listën e ATK-së, mirëpo që në këtë listë nuk gjenden i gjithë stafi, pra mungojnë inxh.dip.ndërtimtarisë – Veton Pira, inxh.Gjeodezis – Fadil Shehu, inxh.dip.Infrastruktures Rrugore-Ardila Lulo dhe Ing.Biologjis – Elez Krasniqi).

SH.P.K. L.L.C AL ENGINEERING PRISHTINË

Tek Kërkesa 6 – është kërkuar Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoje pune profesionale minimum 10 vite , ndërsa konsorciumi në fjalë ka prezantuar inxhinierin por që ky inxhinier nuk ka diplome te nostrifikuar dhe diploma nuk është në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, prandaj ky fakt bie në kundërshtim me nenin 13.4 te LPP-së.

Tek Kërkesa 7 – është kërkuar Një Inxhinier i Diplomuar i Infrastruktures ose master i Infrastruktures, ndërsa konsorciumi në fjalë ka prezantuar inxhinierin por që i njëjti nuk ka diplome te nostrifikuar dhe është nga një shtet tjetër.

Tek Kërkesa 8 – është kërkuar Një Master i Biologjis me licencë valide per VNM nga MMPH, kurse konsorciumi në fjalë ka ofruar dëshmi për këtë Biolog por licenca nuk është valide për VNM nga MMPH sepse i ka skaduar me dt:02.06.2019

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që i cekëm më lartë rezulton se asnjë nga ofertuesit (për veç kompanisë sonë) nuk janë te përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dosjen e tenderit, shihet që kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë – Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Prandaj kur i kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura rezulton se ne jemi ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Gjithashtu kur merret parasysh paramasa dhe parallogaria, e ku vlerësimi është sipas pikëve (100%) (si dokument po e bashkëngjisim vetëm pjesën A pasi edhe pjesët tjera janë të ngjashme), kompania jonë është fituese e këtij tenderi, me ç'rast edhe AK në dy rastet e shpalljes se fituesit kompaninë tonë e rendit te parën me poena.

Në vijim është dhënë se si ka qenë e dizajnuar dhe përgatitur paramasa nga AK-ja.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR SHËRBIME HARTIMI I (PROJEKTEVE DETALE)					
A	**Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore -Ndërtimi i lartë (Objekte publike shkolla, qerdhe, objekte administrative-kulturor, salla sportive, palestra sportive etj)**	**Njesia matese**	**Sasia**	**Çmimi për njësi (meTVSh)-€**	**Totali i projektimit te objekteve (15% e pikeve per vleresim) Totali i me TVSH-€**
1	Punimi i projektit kryesor dhe zbatues - ARKITEKTURA, projekti duhet te projektohet konform standardeve EU dhe kompletimi i tij duhet te jete konform ligjit te ndertimit qe eshte ne fuqi.	m^2	1		
.	... . 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7				

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINE

8	Projektimi i parqeve dhe hapsirave gjelbruese. Projekti duhet te projektohet konform standardeve EU dhe kompletimi i tij duhet te jete konform ligjit te ndertimit qe eshte ne fuqi. (Me matje gjeodezike)	m²	1		
				A - Gjithsej:	

Duke u bazuar në paramasa ku janë parashikuar dhe vendosur kolonat që çmimi të jepet për njësi, dhe vlerësimi të bëhet me poentim duke i përcaktuar edhe pikët për pozicione, ne jemi të renditur i pari me më së shumti pikë në raport me operatorët tjerë ekonomik, prandaj edhe duhet të jemi fitues të këtij tenderi.

Në përgjigjen (jo vendimin) e AK-së të dt:13.06.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim autoriteti kontraktues e pranon që inxhinieri i gjeodezisë i OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka diplomë në gjuhë zyrtare por thotë se mund të përkthehen. Po ashtu e pranon faktin edhe për Biologun dhe thotë se diplomat janë të në gjuhë të kuptueshme. Pra faktikisht e pranon që është i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë. Të njëjtën përgjigje e ka dhënë edhe për dy operatorët ekonomik tjerë, prandaj rezulton se edhe vetë AK-ja e ka pranuar se të tre operatorët ekonomik nuk kanë ofertuar konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe nuk janë zbatuar të gjitha dispozitate LPP-së, sepse operatorët tjerë ekonomik nuk i kanë ofruar dëshmitë siç janë kërkuar konform nenit 68 dhe 69 të LPP-së.
Njëkohësisht në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.
Poashtu duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë rezulton se në këtë aktivitet të prokurimit vetëm ne jemi ofertues i përgjegjshëm, pra në secilin variant ne jemi fitues të kësaj kontrate. Fillimisht në bazë të paramasës ne jemi të renditur me poentim si operatori ekonomik i parë dhe më pastaj edhe operatorët ekonomik tjerë janë të papërgjegjshëm.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa si e bazuar e OE "AL Engineering" sh.p.k
ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.
Gjithashtu kërkojmë nga OSHP, që ta detyroni autoritetin kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi, përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet janë të konsiderueshme, pasi që vetëm përgatitja e dokumentacionit, kërkesës për rishqyrtim, ankesës etj, arrin vlerën prej:5,000.00€.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

1. *Njoftimi për Kontratë (ri-tender), i datës 07.05.2019*
2. *Njoftimin se jemi fitues te kontratës i datës 23.05.2019*
3. *Njoftimin për pezullim (rasti1), i datës 28.05.2019*
4. *Njoftimin për ri-shqyrtim (rasti 1), i datës 31.05.2019*
5. *Njoftimin nga AK se fitues është nsh "3D Project"(rasti 2), i datës 05.06.2019*
6. *Kërkesë ne qasje ne dokumenta (duke u bazuar ne ligjin nr. 03/L-2015), i datës 05.06.2019*
7. *Njoftim (për mes emailit) i lijimit ne qasje ne dokumenta, nga zyra prokurimit – z.Xhevdet Ramosaj, i datës 06.06.2019*
8. *Kërkesë për Rishqyrtim, i datës 10.06.2019*
9. *Njoftimin për pezullim (rasti2), i datës 10.06.2019*
10. *Përgjigje në - Kerkesë për Rishqyrtim (rast 2), i datës 13.06.2019*
11. *FDT e dosjes se tenderit*
12. *Paramasa dhe Parallogaria e dosjes se tenderave*
13. *Emailat e komunikimit me AK – Komuna Deçan*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË